



# Partia Demokratike

## KALLËZIM PENAL

Nr. Prot. ekstra.

Lezhë, më 02.05.2023

- KALLËZUES:** Deputetja Zj. Lindita METALIAJ, njëherazi edhe kryetare e Partisë Demokratike Dega Lezhë, me adresë komunikimi: [lindita.metaliaj@gmail.com](mailto:lindita.metaliaj@gmail.com)
- OBJEKTI:** Kallëzim i veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe “Shpërdorimi i Detyrës” të parashikuar nga Nenet 248 dhe 328 të Kodit Penal.
- KUNDËR:** Pjerin Ndreu, aktualisht me detyrën e Kryetarit të Bashkisë Lezhë, me adresë komunikimi: Bashkia Lezhë.
- BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.95/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Nenet 75/a, 274, 280 dhe 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, neni 248 dhe 328 i Kodit Penal.
- DREJTUAR:** PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT – SPAK.

*I nderuar Z. Drejtues i Prokurorisë së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit – SPAK,*

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, po ju paraqesim kallëzimin për veprat penale të sipërcituara, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat ligjore penale të cënuara, si dhe analizën juridike dhe indiciet e faktet me anë të të cilave vërtetohet konsumimi i veprave penale.

Mbi bazën e informacioneve dhe fakteve të administruara jemi vënë në dijeni të veprimeve të kundraligjshme të personit të kallzuar, kryetarit të Bashkisë Lezhë, i cili, për shkak të funksionit, nëpërmjet veprimeve të tij ka konsumuar veprën penale të “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 329 I Kodit Penal.

Nga ana e Bashkisë Lezhë janë duke u kryer punime në segmentin rrugor kombëtar K/Shëngjin, që I korrespondon lagjes “Xhenjo”. Në tabelën e vendosur në këtë aks rrugor kombëtar ku po zhvillohet projekti rezulton se autoriteti kontraktor është Bashkia Lezhë dhe objekti i punimeve lidhet me shtrimin e trotuarit të ri të rrugës në këtë segment rrugor. Sqarohet se ky segment rrugor është pjesë e inventarit të rrjetit rrugor kombëtar që administrohet nga ARRSH.

Nga të dhënat e administruara rezulton se Autoriteti Rrugor Shqiptar ka konstatuar kryerjen e punimeve nga Bashkia Lezhë në këtë segment rrugor dhe e ka konsideruar të paligjshëm për shkak se kryerja e punimeve është kryer pa autorizimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar, si enti pronar i rrugës kombëtare ku përfshihet ky segment rrugor.

### **LIGJI I APLIKUESHËM:**

Neni 280 i K.Pr. Penale

#### **Marrja dijani për veprën penale**

*“Prokurori dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët”.*

Neni 283 i K.Pr. Penale

#### **Kallëzimi nga ana e shtetasve**

*“1. Çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.*

*2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policies gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.*

*3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre”.*

Neni 75/a i K.Pr. Penale

#### **Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**

*“Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:*

a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;

b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës”.

Neni 328 i Kodit Penal

### **Korrupsioni aktiv në zgjedhje**

“Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t’u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet”.

Neni 248 i Kodit Penal

### **Shpërdorimi i detyrës**

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

Neni 91 i Kodit Zgjedhor

### **Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore**

“1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të

burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimit, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.

5. KQZ-ja nxjerr udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike”.

Neni 14 i Kodit Rrugor:

#### **Të drejtat dhe detyrat e enteve pronare të rrugëve**

“1. Entet pronare të rrugëve, për garantimin e sigurisë dhe rrjedhshmërisë së qarkullimit, kanë për detyrë:

- a) administrimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve, pjesëve që i përkasin rrugës, si dhe të pajisjeve, impianteve dhe mjediseve të shërbimeve;
- b) kontrollin teknik të gjendjes së rrugëve dhe të pjesëve që i përkasin rrugës;
- c) vendosjen dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit të përcaktuar.

2. Entet pronare, gjithashtu, kanë për detyrë:

- a) lëshimin e autorizimeve dhe lejeve, sipas këtij kapitulli;
- b) konstatimin e shkeljeve të dispozitave të këtij kapitulli dhe normave të tjera që kanë lidhje me të, si dhe të normave që përmbahen në autorizimet dhe lejet.

3. Për rrugët në koncesion, të drejtat dhe detyrat e entit pronar të rrugës, të parashikuara nga ky Kod, ushtrohen nga koncesioneri, përveç rasteve kur vendoset ndryshe”.

Neni 26 i Kodit Rrugor:

#### **Kompetenca për autorizime dhe koncesione**

“1. Autorizimet, sipas këtij kapitulli lëshohen nga enti pronar i rrugës ose nga ndonjë ent tjetër i deleguar prej tij apo nga enti koncesioner i rrugës, në përputhje me kontratën përkatëse; delegimi i

njoftohet ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse ose organit kompetent të pushtetit lokal, kur bëhet fjalë për ente lokale.

2. Autorizimet dhe koncesionet, sipas këtij kapitulli, janë kompetencë e entit pronar të rrugës, kurse për rrugët në koncesion vepron sipas kontratës përkatëse.

3. Për pjesët e rrugëve shtetërore, të rrethit që kalojnë brenda qendrave të vogla të banuara, lëshimi i autorizimit a koncesionit është kompetencë e komunës<sup>5</sup>, pasi të jetë marrë miratimi i entit pronar të rrugës.

4. Vendosja në rrugë dhe pjesët që i përkasin asaj, e linjave hekurudhore, tubacioneve a kanalizimeve të tjera të destinuara për përdorim publik, ose edhe vetëm përshkimi i rrugës dhe pjesëve që i përkasin asaj me objektet e mësipërme, autorizohet, vetëm në rastet e domosdoshme, kur është e pamundur teknikisht çdo zgjidhje tjetër, me urdhër të ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse dhe të entit pronar të rrugës ose në marrëveshje me Ministrinë e Mbrojtjes, kur bëhet fjalë për rrugë ushtarake”.

### **ANALIZA LIGJORE:**

Nga indiciet, provat dhe faktet e paraqitura, ka vend për dyshime të arsyeshme se shtetasi Pjerin Ndreu në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Lezhë, ka kryer veprën penale “Shpërdorimit të detyrës” dhe të “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 248 dhe 328 i Kodit Penal.

Neni 328

#### **Korrupsioni aktiv në zgjedhje**

“Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t’u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën veprën penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet”.

**Objekti** i kësaj vepre penale është mbrojtja e marrëdhënieve të vendosura për të garantuar zbatimin e ligjeve të vendit dhe mos-shkelja e tyre për të demtuar apo deformuar proceset elektorale dhe zgjedhore dhe për të shmangur deformimin e vullnetit të votuesve me qëllim për të mbrojtur të drejtën e votes, lirinë e mendimit dhe të zgjedhjes lirisht e pa ndikime të perfaqësuesve të qytetarëve gjatë fustave dhe pergjate proceseve zgjedhore.

**Nga ana objektive**, kjo veprë penale janë kryhet me veprime të drejteperdrejta që konsistojnë në shpërndarjen e parave publike, të mirave materiale, premtimin për vende pune apo favorizime në cilëndo formë për zgjedhësin apo persona të tjerë me qëllim deformimin e vullnetit të zgjedhësve.

**Subjekt i veprës penale** është shtetasi që është i përgjegjshëm para ligjit dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale

Nga ana subjektive kjo vepër penale kryhet me dashje.

Sic e përmendëm edhe më lart, shtetasi Pjerin Ndreu, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Lezhë ka urdhëruar kryerjen e punimeve në segmentin rrugor kombëtar K/Shëngjin, që i korrespondon lagjes “Xhenjo”. Në tabelën e vendosur në këtë aks rrugor kombëtar ku po zhvillohet projekti rezulton se autoriteti kontraktor është Bashkia Lezhë dhe objekti i punimeve lidhet me shtrimin e trotuarit të ri të rrugës në këtë segment rrugor. Sqarojmë se ky segment rrugor është pjesë e inventarit të rrjetit rrugor kombëtar që administrohet nga ARRSH dhe nuk është nën administrimin dhe juridiksionin e Bashkisë Lezhë.

Nga të dhënat e administruara rezulton se Autoriteti Rrugor Shqiptar ka konstatuar kryerjen e punimeve nga Bashkia Lezhë në këtë segment rrugor dhe e ka konsideruar të paligjshëm për shkak se kryerja e punimeve është kryer pa autorizimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar, si enti pronar i rrugës kombëtare ku përfshihet ky segment rrugor.

Në nenin 14 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë “Të drejtat dhe detyrat e enteve pronare të rrugëve” parashikohet si më poshtë:

1. Entet pronare të rrugëve, për garantimin e sigurisë dhe rrjedhshmërisë së qarkullimit, kanë për detyrë :

a) administrimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve, pjesëve që i përkasin rrugës, si dhe të pajisjeve, impianteve dhe mjediseve të shërbimeve;

b) kontrollin Teknik të gjëndjes së rrugëve dhe të pjesëve që i përkasin rrugës;

c) vendosjen dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit të përcaktuar.

2. Entet pronare, gjithashtu kanë për detyrë :

a) Lëshimin e autorizimit dhe lejeve, sipas këtij kapitulli;

b) Konstatimin e shkeljeve të dispozitave të këtij kapitulli dhe normave të tjera që kanë lidhje me të, si dhe normave të dispozitave që përmbahen në autorizimet dhe lejet.

Ndërsa në nenin 26 të Kodit Rrugor është përcaktuar :

1. Autorizimet sipas këtij kapitulli, lëshohen nga enti pronar i rrugës ose nga ndonjë ent tjetër i deleguar prej tij apo nga enti koncensionar i rrugës, në përputhje me kontratën përkatëse.

2. Autorizimet dhe koncensionet, sipas këtij kapitulli, janë kompetencë e entit pronar të rrugës, kurse për rrugët në koncension veprohet sipas kontratës përkatëse.

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave të Kodit Rrugor rezulton qartë se segmenti rrugor në të cilën është duke kryer punimet Bashkia Lezhë, është në inventarin e Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe ky i fundit, sipas ligjit, ka detyrimin për administrimin, mirëmbajtjen, kontrollin teknik, pastrimin e rrugëve dhe të pjesëve që i përkasin rrugëve. Entet pronar të rrugëve (në rastin konkret Autoriteti

Rrugor Shqiptar), mund të lëshojë autorizim ose leje në ente të tjera për kryerjen e punimeve apo pastrimit të rrugëve.

Në rastin objekt kallëzimi, Kryetari i Bashkisë Lezhë, në mungesë të autorizimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, duke urdhëruar kryerjen e punimeve me fondet e Bashkisë Lezhë në këtë segment rrugor jashtë juridiksionit të Bashkisë Lezhë, ka vepruar në kundërshtim të hapur me parashikimet ligjore të nenit 14 dhe 26 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Në këto rrethana, kryetari i Bashkisë Lezhë ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin.

Nisur nga koha në të cilën janë duke u kryer këto punime, e cila përkon me periudhën e fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale 14 Maj 2023, kryerja e këtij veprimi të kundërligjshëm nga ana e kryetarit të Bashkisë Lezhë bie gjithashtu në kundërshtim me nenin 91 pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë ku parashikohet:

*Me përjashtim të rasteve të parashikara në ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo cdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale ose kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikqyrësapo organit administrues të entit , pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.*

Nisur nga problematikat dhe shkeljet ligjore të kryera në vazhdimësi gjatë zgjedhjeve qendrore dhe lokale me pasojë deformimin e vullnetit të votuesve, jo pa qëllim, ligjvënësi me qëllim shmangjen e ndikimit të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore dhe publike (qendrore apo lokale), ka vendosur norma ndaluese ligjore si në ligje të vecanta (Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë) ashtu edhe në Kodin Penal. Në Kodin Penal janë parashikuar dispozita të posacme (krime elektorale) të cilat synojnë mbrojtjen e marëdhënieve që lidhen me ligjshmërinë e proceseve elektorale/zgjedhore si dhe garantimin e të drejtës së votimit dhe vullnetit të votuesve për të zgjedhur lirshëm dhe jashtë cdo ndikimi përfaqësuesit e tyre në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale.

Në rastin e kallzuar ngrihen dyshime të arësyeshme të bazuara në prova se përdorimi i fondeve të Bashkisë Lezhë për kryerjen e punimeve në periudhën e fushatës zgjedhore, për më tepër në një segment rrugor që është nën zotërimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar, ka si qëllim final ndikimin dhe deformimin e vullnetit të votuesve të kësaj zone për të orientuar votën e zgjedhësve drejt kandidatit të forcës politike që kryetari i Bashkisë Lezhë përfaqëson.

Pavarësisht se në vështrim të përgjithshëm kryerja e punimeve për ndërtimin e trotuarit në segmentin rrugor të lagjes “Xhenjo” mund të konsiderohet si një investim në interes të publikut, nisur nga rrethanat e çështjes si: përdorimi i fondeve të Bashkisë Lezhë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Rrugor, pa qenë e pajisur nga ARRSH me autorizim për kryerjen e punimeve si dhe kryerja e punimeve në periudhën e fushatës zgjedhore, vlerësojmë se kryerja e këtyre veprimeve ka si qëllim ndikimin dhe deformimin e vullnetit të votuesve të kësaj zone për të orientuar votën e zgjedhësve drejt kandidatit të forcës politike që kryetari i Bashkisë Lezhë përfaqëson.

Në këto rrethana, veprimet me dashje të kryetarit të Bashkisë Lezhë, Pjerin Ndreu, kanë çenuar marëdhëniet e mbrojtura nga neni 328 i Kodit Penal. Nëpërmjet urdhërimit për kryerjen e punimeve në kundërshtim me parashikimet ligjore të sipërcituara me synimin e vetëm për të ushtruar ndikim dhe

oreintuar votuesit e kësaj zone për të votuar kandidatin për kryetar Bashkie të Partisë Socialiste, është konsumuar ana objektive e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. Këto veprime janë kryer me dashje, pasi kryetari i Bashkisë Lezhë ka qenë i ndërgjegjshëm për shkeljen e dispozitave të ligjeve të posacme (Kodi Zgjedhor dhe Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë) si dhe nenit 328 të Kodit Penal që mbron marëdhëniet e vendosura për të garantuar rregullsinë e proceseve elektorale dhe të drejtën e votuesit për të votuar lirshëm dhe jashtë cdo ndikimi.

Gjithashtu, ne konstatojmë se me veprimet dhe mos veprimet e tij, z. Ndreu ka kryer shkelje ligjore, që në rast se nuk kualifikohet në një dispozitë të veçantë, nga SPAK duhet të cilësohet minimalisht si shkelje e Nenit 248 të Kodit Penal, “Shpërdorimi i detyrës”.

Sipas kësaj dispozite, përcaktohet qartë se konsiderohet abuzim (shpërdorim) i detyrës:

*“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.*

Duke gene se: (i) Kreu aktual i Bashkisë Lezhë nuk ka marrë masat e duhura për kryerjen e punimeve rrugore sipas lejeve, autorizimeve përkatëse, të parashikuara nga Ligjet në fuqi (pa qenë pajisur nga ARRSH me autorizim për kryerjen e punimeve), si dhe duke qenë se, (ii) përfitimi material dhe jo material kryer nga shpërdorimi i detyrës provohet drejtëpërdrejtë nga kryerja e punimeve në periudhën e fushatës zgjedhore, e cila nuk ka qëllim tjetër veçse ndikimin dhe deformimin e vullnetit të votuesve të Lezhës për të orientuar votën e zgjedhësve drejt votimit të po vetë kreut aktual të Bashkisë Lezhë (i cili rikandidon), në të tilla kushte, krijohet bindja e arsyeshme se z. Ndreu ka konsumuar më së paku veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

#### **KONKLuzion:**

Nga sa analizuam më sipër, duke vlerësuar se nga ana e kryetarit të Bashkisë Lezhë, Pjerin Ndreu janë konsumuar elementet e veprës penale të “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, si dhe të “Shpërdorimit të Detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, përfundimisht kërkojmë nga SPAK:

**Regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj kryetarit të Bashkisë Lezhë, z. Pjerin Ndreu për veprat penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, dhe “Shpërdorimi i Detyrës”, parashikuar nga neni 248 dhe 328 i Kodit Penal.**



*dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.*

Duke qene se: (i) Kreu aktual i Bashkisë Lezhë nuk ka marrë masat e duhura për kryerjen e punimeve rrugore sipas lejeve, autorizimeve përkatëse, të parashikuara nga Ligjet në fuqi (pa qenë pajisur nga ARRSH me autorizim për kryerjen e punimeve), si dhe duke qënë se, (ii) përftimi material dhe jo material kryer nga shpërdorimi i detyrës provohet drejtëpërdrejtë nga kryerja e punimeve në periudhën e fushatës zgjedhore, e cila nuk ka qëllim tjetër veçse ndikimin dhe deformimin e vullnetit të votuesve të Lezhës për të orientuar votën e zgjedhësve drejt votimit të po vetë kreut aktual të Bashkisë Lezhë (i cili rikandidon), në të tilla kushte, krijohet bindja e arsyeshme se z. Ndreu ka konsumuar më së paku veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

### **KONKLuzion:**

Nga sa analizuam më sipër, duke vlerësuar se nga ana e kryetarit të Bashkisë Lezhë, Pjerin Ndreu janë konsumuar elementet e veprës penale të “**Korrupsioni aktiv në zgjedhje**”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, si dhe të “**Shpërdorimit të Detyrës**”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, përfundimisht kërkohet nga SPAK:

**Regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj kryetarit të Bashkisë Lezhë, z. Pjerin Ndreu për veprat penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, dhe “Shpërdorimi i Detyrës”, parashikuar nga neni 248 dhe 328 i Kodit Penal.**

Bashkëlidhur kallëzimit, po paraqesim provat si vijon:

1. Shkresen NR 2172 PROT , DT 09.03.2023 te ARRSH drejtuar Bashkise Lezhe , per nderprejten e punimeve ne segmentin rrugor K/Shengjin ~ Shengjin.
2. Foto , ku faktohet qe ne ate aks rrugor puna nuk eshte nderprere asmje moment, ne kundërshtim me vendimin e ARRSH per nderprejten e punimeve .

**KALLËZUES:**

**LINDITA METALIAJ**

**DEPUTETE DHE KRYETARE E PD – DEGA “LEZHË”**



**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**  
**DREJTORIA E NDËRTIMIT DHE MIRËMBAJTJES**  
**SEKTORI I MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE**

Nr. 2172 Prot.

Tiranë, më 03.03, 2023

Lënda: Mbi punimet e paautorizuara në segmentin rrugor kombëtar K/Shëngjin – Shëngjin.

**BASHKISË LEZHË**  
 Lagjja “Skënderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhë ✓

Nga inspektimi i specialistëve të ARRSH, në kuadër të punimeve të kryera në kontratën e mirëmbajtjes “Loti 1 – Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Verior”, u konstatua se në segmentin rrugor kombëtar K/Shëngjin – Shëngjin, po kryheshin punime për realizimin e projektit të Bashkisë Lezhë me objekt: “Ndërtimi i trotuarit të ri në lagjen “Xhenjo”.

Theksojmë se segmenti rrugor K/Shëngjin – Shëngjin, është pjesë e inventarit të rrjetit rrugor kombëtar që administrohet nga ARRSH.

Në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 14 “Të drejtat dhe detyrat e enteve pronare të rrugëve”, ku thuhet shprehimisht:

1. Entet pronare të rrugëve, për garantimin e sigurisë dhe rrjedhshmërisë së qarkullimit, kanë për detyrë:
  - a) administrimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve, pjesëve që i përkasin rrugës, si dhe të pajisjeve, impianteve dhe mjediseve të shërbimeve;
  - b) kontrollin teknik të gjendjes së rrugëve dhe të pjesëve që i përkasin rrugës;
  - c) vendosjen dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit të përcaktuar.
2. Entet pronare, gjithashtu, kanë për detyrë:
  - a) lëshimin e autorizimeve dhe lejeve, sipas këtij kapitulli;
  - b) konstatimin e shkeljeve të dispozitave të këtij kapitulli dhe normave të tjera që kanë lidhje me të, si dhe normave që përmbahen në autorizimet dhe lejet.

dhe neni 26 “Kompetenca për autorizime dhe koncensione”, ku thuhet shprehimisht:

1. Autorizimet, sipas këtij kapitulli, lëshohen nga enti pronar i rrugës ose nga ndonjë ent tjetër i deleguar prej tij apo nga enti koncensionar i rrugës, në përputhje me kontratën përkatëse;
2. Autorizimet dhe koncensionet, sipas këtij kapitulli, janë kompetencë e entit pronar të rrugës, kurse për rrugët në koncension vepron sipas kontratës përkatëse,

enti i vetëm që duhet të miratojë projektin e ndërhyrjes, është Autoriteti Rrugor Shqiptar.



Autoriteti Rrugor Shqiptar | Rruga Sami Frasheri, Nr.33, Tiranë. Email: info@arrsh.gov.al | Tel: 04 22 34 487



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E NDËRTIMIT DHE MIRËMBAJTJES  
SEKTORI I MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE

Në tabelën e vendosur për zhvillimin e projektit, është afishuar kohëzgjatja e kryerjes së punimeve, e cila është 5 muaj. Kjo kohëzgjatje, tregon se punimet do të vijojnë edhe gjatë sezonit turistik veror, kur dhe fluksi i qarkullimit është më i madh.

Në përmbushje të detyrimeve, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka përgjegjësinë për mirëmbajtjen, përmirësimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe sigurimin e një qarkullimi komod dhe të sigurt për të gjithë përdoruesit e rrugës.

Sa më sipër, në zbatim të Kodit Rrugor, kërkojmë nga ana juaj, ndërprerjen e menjëhershme të punimeve, dhe dërgimin sa më parë në Autoritetin Rrugor Shqiptar të projektit të plotë që do zbatohet, i cili duhet të miratohet nga ana jonë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



